



Npi – 01/91 datë: 14.05.2020

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/149 të datës: 31.05.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 14.05.2020 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -III- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES

E mbajtur më: 14.05.2020, e (enjte) në ora 10.^{oo} h. në sallën e Shtëpisë së Kulturës për arsye të përhapjes së Pandemisë KOVID19 e njohur si (Korona-Virus).

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Medina Brahaj, Perparim Ramusa, Shefki Dauti, Herolind Selmani, Reshat Mujota, Arbresha Sylla, Milot Deliu, Fatmire Ferati, Naim Zejna, Skender Hyseni, Zarife Rexhaj, Valentina Halili-Ferati, Ruzhdi Jashari, Besnik Seferi, Marigona Pajaziti, Fehmi Hysenaj, Adelina Beqaj, Isak Muslija, Diarta Vishesella, Muhamet Ademaj, Rexhep Gashi.

Përveç delegatëve në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Naim Ismajli, Drejtorët; z.Halil Halili dhe z.Labinot Beqa; Zyrtarja Kryesore Financiare, znj.Kimete Uka; Zyrtari për Informim z.Lulzim Sahiti; Zyrtari i IT-së Gazmend Ademaj; Nga Radio Zëri i Shtimes, z.Muhamet Hoxha.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar mbledhjen. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Informatë e përgjithshme mbi gjendjen me Korona Virus në Komunën e Shtimes,
2. Propozim-Vendim për rritjen e Kulmit Buxhetor, të vitit 2019 nga realizimi i të hyrave vetanake,
3. Propozim-Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2019 në vitin 2020,
4. Propozim-Vendim për lirimin nga taksa Komunale për personat juridik.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapë diskutimin për rendin e ditës, tha disa fjalë për Pandemin KOVID19, ku tha se fatmirësisht jemi në rrugë të mirë për ta kaluar këtë Pandemi, prandaj edhe po e mbajmë këtë mbledhje në kushte pak më të lira se sa më parë. Kështu që e shfrytëzoj rastin ti falënderoj të gjithë ata që kontribuan për parandalimin e përhapjes së kësaj Pandemie. Në vazhdim Kryesuesja hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Naim Zejna; Përshëndetje, unë e përkrahu rendin e ditës, mirëpo ne jemi marrë vesh që ta kemi në rendin e ditës edhe pikën Pyetje-Përgjigje, prandaj propozoj që edhe këtë pikë ta fusim në rendin e ditës.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Ende jemi në gjendje Pandemie, kështu që edhe drejtorat nuk janë të gjithë prezent, prandaj edhe nuk e kemi propozuar këtë pikë.

z.Ruzhdi Jashari; Përshëndetje, ne edhe në KPF-ë kemi kërkuar që ta kemi në rendin e ditës edhe pikën e shqyrtimit të Procesverbalit, sepse nuk ka më pengesa. Kështu që unë mendoj se është dashur që ta kemi edhe Procesverbalin si pikë e rendit të ditës.

z.Fehmi Hysenaj; Përshëndetje, e kemi marrë me kohë rendin e ditës, meqenëse ka filluar që të normalizohet gjendja nga pandemia, unë nuk e shoh të arsyeshme që në këtë mbledhje ti kemi edhe

pikat Pyetje-Përgjigje, dhe Procesverbalin, por që pres që në mbledhjen e ardhshme ti kemi në rendin e ditës. Kështu që unë e përkrahu këtë rend të ditës.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, me 16 vota “Për” dhe me 4 vota “Abstenim” aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika 1

Informatë e përgjithshme mbi gjendjen me Korona Virus në Komunën e Shtimes

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kryetarit.

Kryetari, z. Naim Ismajli; Përshëndetje, tani ne mund të flasim për një gjendje më të mirë dhe më të lirë nga që e kishim ditë më parë nga Pandemia e Korona-Virusit. Na vjen keq që në komunën tonë kishim edhe një rast të humbjes së jetës. I falënderoj të gjithë ata që punuan pa u ndalur në parandalimin e Pandemisë KOVID19. Unë në fund do të përgatis edhe një raport të përgjithshëm për këtë Pandemi. I falënderoj po ashtu edhe qytetarët që ju kanë përmmbajtur udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik. Kemi vazhduar edhe me shpërndarjen e pakove ushqimore dhe higjienike, ku i falënderojmë të gjitha OJQ-të si donatorë që na kanë ndihmuar për ta tejkaluar këtë situatë. Kemi disa biznese që i janë kthyer punës. Është e qartë se do të kemi vështërsi të mëdha që të kthehemi në normalitet, por besoj se edhe ju si Kuvend me vendimet që do ti merrni, për ndryshimet që do të duhet të bëhen në Buxhet, do ti përkrahni në parim këto masa, për dalje nga kjo situatë, sepse me këtë strukturë të buxhetit që e kemi nuk mund të ecet përpara. Në fund i falënderoj të gjithë, mirëpo më së vështiri e kanë pasë Shëndetësia, Policia, Zjarrfiksat, etj. Është mirë që sot kemi një trend të normalitetit.

z. Fehmi Hysenaj; Faleminderit, Kryetar për ekspozenë, edhe informatën e dërguar. Unë nuk kam të shtoj diçka për informatën por kam disa shqetësime. Shteti duhet të intervenoj përmes Policisë që mos me lejuar që me dalë grupe me shumë persona, sepse unë kam pa grupe të rinjsh me nga 7-8 persona bashk pa mjete mbrojtëse. Ky mundë që është bërë deri tash nuk duhet me e lënë që të shkojë kot. Pastaj shqetësimi tjetër është se në disa Markete punëtorët aty nuk mbajnë fare maska, mendoj se Inspektorët duhet të kontrollojnë më shumë.

z. Muhamet Ademaj; Përshëndetje, faleminderit për Informatën. E vlerësoj punën e Shtabit Emërgjent për ndihmën me pakot që u janë shpërndarë familjeve në nevojë. Po ashtu i falënderoj të gjitha barnatoret, furrat e bukës, marketet që i kanë furnizuar qytetarët edhe në këto kushte të vështira. Tash sot kemi lajm të mirë që kemi zero raste të infektuar me virusin korona. Kemi pas 19 raste të prekur me Korona-Virus, të cilëve u uroj shërim sa më të shpejtë, ndërsa për humbjen e familjarëve u shprehu ngushllime.

z. Ruzhdi Jashari; Përshëndetje, krejt kjo me një informatë nuk do të thot se është kryer puna. Ne kërkojmë një informatë gjenerale të detajuar me të dhëna për aktivitetet, donacionet, si dhe shpenzimet e bëra gjatë kësaj periudhe të Pandemisë KOVID19. Për një falënderim janë punëtorët e shëndetësisë, policisë, pastërtisë, pastaj donatorët e ndryshëm. Pandemia nuk ka kaluar, sepse edhe më tutje kërkohet respektim i masave parandaluese të përhapjes së këtij virusi. Këto dertyra i ka Shtabi Emërgjent. Ngushllime për familjarët që i kanë humbur të dashurit e tyre.

z. Perparim Ramusa; Përshëndetje, faleminderit për Informatën. Nga Shtabi Emërgjent është bërë një punë e mirë. I përshëndes për punën e mirë, Mjekët si dhe stafin ndihmës, policët, punëtorët e pastërtisë. Në përgjithësi unë mund të them se menaxhimi i kësaj Pandemie në komunën tonë ka qenë i mirë. Unë po besoj se nga kjo Pandemi do të dalim fitues, me sa më pak të infektuar.

z. Shefki Dauti; Përshëndetje, faleminderit për Informatën. Ne si Komunë, mjaft mirë e kemi menaxhuar Pandeminë, tregojnë edhe rastet që mnuk ka pasur edhe aq shumë raste të infektuarve. E falënderojmë Shtabin Emërgjent, Stafin mjeksor, Policinë, punëtorët e Pastërtisë. Unë jam i mendimit që në pakon emërgjente të përfshihen edhe 27 punëtorët e KRM “Pastërtia” në vlerë me nga 100€.

z. Rexhep Gashi; Përshëndetje, faleminderit për Informatën, që e dha Kryetari, si dhe për stafin e shëndetësisë, policisë, dhe punëtorët e kompanis pastërtia. Unë kam një pyetje për Kryetarin, në

Shtabin Emërgjent është vendosur që fshati Pjetërshticë me u futë në Karantinë, unë po dua tani ta di se a është futur fshati Pjetërshticë në Karantinë apo jo?

Kryetari, z.Naim Ismajli; Flm. Për pyetjen, sa do të madhe ta kemi informatën nuk do të mjaftonte, kështu që ju do ta keni një raport të detajuar me të gjitha të dhënat. Ju ftoj që secili delegat që ka identifikuar ndonjë parregullsi ta ngritë këtu, e më pastaj, unë vetë do ta ngriti në nivelin e hetimeve. Ne do ta vërtetojmë secilën informatë të juaj. Pajtohem me Fehmiun, që ka nevojë, me pas kujdes me respektimin e masave. Ne kemi kërkuar por prap do të kërkoj që secili punëtor të përdorë maskat mbrojtëse, në të kundërtën të mirren masat adekuate. Pjetërshtica është shpallur zonë nën karantinë nga Ministria e Shëndetësis me propozimin tonë. Ndërkaq që Instituti i Shëndetit Publik ka thënë se nuk ka nevojë që ky fshat të jetë nën karantinë, por të konsiderohet si vatër e pandemisë, pastaj edhe një pjesë e fshatit Godanc i poshtëm.

Pika 2

Propozim-Vendim për rritjen e Kulmit Buxhetor, të vitit 2019 nga realizimi i të hyrave vetanake
Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha, znj.Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Përshëndetje, propozim-vendimin e kemi përgatitur në formë të shkruar dhe ua kemi dërguar me kohë, mendoj se nuk ka nevoj me e lexuar krejt propozimin, sepse keni pas kohë të mjaftueshme për ta përpunuar, por megjithate po i përmendi disa detaje më kryesore. Pastaj nëse ka pyetje unë jam këtu për tu përgjigjur. (shih dokumentin)

z.Perparim Ramusa; Për këtë propozim-vendim kemi diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për aprovim. Po flasim për tejkalimin e inkasimit të hyrave vetanake për 21.200€ por për me mujt me i shfrytëzuar këto mjete na nevojitet ta marrim paraprakisht një vendim për rritjen e kulmit buxhetor për vitin 2019. Unë i propozoj Kuvendit që ta aprovojë këtë vendim për rritjen e kulmit buxhetor.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi Vendim për rritjen e Kulmit Buxhetor, të vitit 2019 nga realizimi i të hyrave vetanake.**

Pika 3

Propozim-Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2019 në vitin 2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Njoftoi Kuvendin, se më heret kemi pas një vendim të Kuvendit që kishte të bënte me ndërtimin (kompletimin) rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza në Lagjen Ademaj të fshatit Petrovë, unë dua të ju njoftoj se atëher kemi thënë se do ta përkrahim nga mjetet vetanake, prandaj po ju njoftoj se duhet ta kemi parasysh. Kemi edhe Rekomandimin e KPF-së ku ka rekomanduar që të aprovohet. Në vazhdim fjalën ja dha znj.Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Lexoi të gjitha shumat e propozuara me këtë Propozim-Vendim sipas tabelave. Po ashtu kjo lexoi edhe arsyetimin e dhënë për secilin projekt veq e veq. Ju e keni pranuar këtë dokument dhe besoj se e keni lexuar, unë nuk do ta zgjati më shumë i mirpres pyetjet ose sygjerimet e juaja. (Shih dokumentin)

z.Muhamet Ademaj; Faleminderit për prezantimin. Sa i përket ndarjes së mjeteve nga të hyrat, ne e kemi pas një kërkesë për vazhdimin e kanalizimit të ujërave të zeza në Lagjen Ademaj – Petrovë, kështu që edhe unë e përkrahu këtë ndarje ashtu siq e potencoi edhe Kryesuesja.

z.Perparim Ramusa; Meqenëse në KPF-ë nuk e kemi pas këtë kërkesë, sidoqoftë unë mendoj se ne duhet ti ndajmë 5000€ për kanalizimin e lagjës Ademaj-Petrovë. Mendoj se propozimet që janë bërë të administrata, pastaj te qerdhet në këtë kohë pandemie janë mjete tepër që duhet shikuar. Këtë mendim e kamë dhënë edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa.

z.Ruzhdi Jashari; Ende pa u bërë një vit te financat i kemi tri ndërrime të zyrtarëve kryesor financiar. Unë kam një pyetje konkrete te kodet buxhetore, a janë projekte në vazhdimësi apo është ndonjë projekt shtesë te shpenzimet kapitale? Për sa i përket projektit të kanalizimit në lagjen Ademaj ne e

mbështesim, sepse projekti ka ngelur në gjysëm, dhe ka pas paknaqësi te banorët e lagjes siq e dimë. Unë jam i mendimit se puna aty duhet të kryhet një herë e mirë. Kemi edhe disa propozime të projekteve mjaft të pa qarta kërkoj nga ZKF-ja që projektet të specifikohen mirë dhe të jenë të qarta për anëtarët e Kuvendit.

z.Shefki Dauti; Edhe unë jam për me i nda një sasi të mjeteve financiare për projektin e kanalizimit të lagja Ademaj, por nuk u specifikua se prej cilit kod buxhetor të mirren. Besoj se Kryetari na jep një spjegim. Unë mendoj se kjo ndarje buxhetore është propozuar mjaft mirë prandaj edhe si të tillë unë e përkrahu.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, pajtohem parimisht me diskutimet paraprahe. Unë këtu e kam fjalën për rregullimin e rrugës “Qamëria” ku edhe Kryetari ka thënë se do të rregullohet kanalizimi atmosferik në këtë rrugë. Mendoj se është ndryshuar projekti komplet, sepse nuk është bërë projekti ashtu siq është dashur të realizohet. Nga drejtori më është thënë se projekti do të ndahet në gjysëm, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Propozoj që të hiqen projektet nga kodi buxhetor mallra dhe shërbime, me qëllim që të mundësohet vazhdimi dhe përfundimi si duhet i këtij projekti.

z.Naim Zejna; Kemi problem me materialin sepse nuk e kemi në hard-copy. Pozicioni të administrata nuk na ka pelqyer të gjithëve dhe kemi kërkuar që të ndryshohet. Ndryshimi i kulmit buxhetor për vitin 2019 është 21.200€. Edhe unë e përkrahu ndërtimin ose vazhdimin e ndërtimit të pjesës së kanalizimit që ka mbetur në lagjen Ademaj. Para së gjithash është mirë që po kemi mjete për me nda për projekte të ndryshme. E përkrahu ndarjen e propozuar.

z.Rexhep Gashi; Po ndalem te asfaltimet dhe kanalizimet e rrugëve që janë propozuar, unë kam kërkuar edhe më parë por edhe tani po kërkoj që projektet duhet të specifikohen, pra duhet të precizohet rruga, gjatësia, nëse është fjala për projektet që duhet të shtohen financat atëher duhet të na treguni shumat sa janë dhënë dhe sa po kërkohet që të përfundohet ai projekt, këto të dhëna tani më i keni sepse i kemi emërtimet e rrugëve. E kam ngritur disa herë qështjen e kanalizimit të rruga “Pjetërshtica” në fshatin Gjyrkovc, kanë dalë edhe Inspektorët dhe e kanë konstatuar gjendjen në teren. Aty afër rreth 200 metra largësi kemi edhe grumbullim të ujërave të zeza nga fshati Bujan i Komunës së Lipjanit, unë po e pyes Kryetarin se qka do të ndodhë me ato ujëra të zeza kur do të largohen?

Kryetari, z.Naim Ismajli; Po sqaroj që mjetet e bartura janë realizuar në muajin Nëntor e Dhjetor që nuk ka mundësi për me u realizuar jo pse nuk kemi pas kohë por për shkak të procedurave financiare. Qdo euro që realizohet mbi tejkalimin e kulmit buxhetor, për me pas mundësinë për me i shfrytëzuar kërkohet strikt që të rritet kulmi buxhetor i atijë viti. Në projektet tjera janë të përfshira projektet dy vjeqare të cilat faktikisht janë në vazhdimësi të realizimit të tyre. Për projekte të reja sot nuk mundeni me marrë ndonjë vendim sepse nuk lejohen, por së shpejti kemi me diskutuar për rishikimin e buxhetit. Te rruga “Pjetërshtica” me sa e di unë është e paraparë edhe ajo rrugë me rreth 100 metra, nëse jo mbaje mend Rexh se kemi me biseduar për atë pjesë. Projektet e ujërave atmosferike në zonat rurale, për me rrjedhë në kanalet e hapura, aty ku po thot Besniku, nuk mundemi me i lënë ashtu të hapura, kështu që duhet të kemi specifikacion të sakt për gjendjen në teren dhe pastaj do ta vazhdojmë.

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Për fshatin Gjyrkovc janë ndarë mjete për vitin 2020. Në vazhdim sqaroi dhe arsyei propozimet që janë dhënë te kodet buxhetore administratë, dhe inspektorat duke lexuar të dhënat sipas tabelave në dokument.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje, dhe sqaroi se sipas diskutimeve që dualën këtu unë po e vej në votim këtë pikë së bashku me propozimin që për lagjen Ademaj të ndahen 5000€ por paraprakisht ta konstatojmë nëse ka mundësi ligjore, dhe po kërkojmë një sqarim nga Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Nëse projekti ka qenë në vitin 2019, që Lagja ademaj të futet me kod buxhetor nga mjetet e participimit atëher nuk ka pengesa.

*** Kuvendi i Komunës, me 18 vota “Për” dhe me 1 votë “Abstenim” aprovoi Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2019 në vitin 2020, me propozimin që për lagjen Ademaj të ndahen 5000€ për kanalizimin e ujërave të zeza.**

Pika 4

Propozim-Vendim për lirimin nga taksa Komunale për personat juridik

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z. Fehmi Hysenaj; Unë po kërkoj një sqarim shtesë të pika e dytë e propozim-vendimit. Po dëshiroj ta di se cilat automjete, dhe pse duhet liruuar.

z. Muhamet Ademaj; Edhe ekonomia është goditur nga Pandemia. Unë mendoj se na duhet një plan emërgjent për dalje nga kriza. Sidoqoftë unë e përkrahu këtë propozim për lirimin nga taksa, sado pak që mund të ndikojë te bizneset.

z. Naim Zejna; Unë desha ta di se cili është implikimi buxhetor i këtyre lirimeve. Unë jam i mendimit se më mirë do të ishte sikur ne ta bëjmë një rishikim total të rregullores për taksa.

Kryetari, z. Naim Ismajli; Këtu po bëhet fjalë për lirimin e atyre bizneseve që janë furnizues me mallra në zonat ku faktikisht janë të ndaluara por që hyrja është e lejuar me pagesë të caktuar me taksë komunale, prandaj kemi menduar që të propozojmë që edhe këto të lirohen për shkak të pandemisë KOVID19. Një analizë që e kemi bërë, kemi ardhur në përfundim se jemi te vlera financiare që është nën 20.000€

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Kuvendi Komunës, unanimitisht aprovoi Vendimin për lirimin nga taksa Komunale personat juridik dhe fizik.**

Pasi që diskutime tjera nuk kishte Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 11.37h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj

